

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**

**DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË**

**PROGRAMI GJEOGRAFI**



**PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

Nxënia e njohurive gjeografike të nxënësve të klasave 6-9 në Obiliq dhe Prishtinë, nëpërmjet vizitave në zona të veçanta natyrore dhe kulturore të vendit

Mentori:

Prof. Ass. dr. Fitim Humolli

Kandidatja:

Zethane Shala

*Prishtinë, Prill 2024*

## ABSTRAKT

Ky punim synon të vlerësojë nxënien atraktive të njohurive gjeografike të nxënësve, kryesisht të klasëve 6-9, nëpërmjet vizitave në zona të veçanta natyrore dhe kulturore të vendit.

Aktivitetet jashtëshkollës janë gjithëçka jashtë shtëpisë, klasës së nxënësve, që i ndihmon ata të ndërtojnë aftësi shoqërore, vetëvlerësim dhe të qëndrojnë të shëndetshëm, qoftë mendërisht, emocionalisht apo fizikisht.

Meqenëse gjeografia është një nga lëndët shkollore të bazuara në aktivitete, efektiviteti i mësimdhënies në shkollë mund të rritet, duke organizuar vizita në terren (në zona të veçanta natyrore dhe kulturore të vendit). Vizitat edukative duhet të organizohen në vende të përshtatshme. në kohë të përshtatshme, konform moshës për të nxënëit e njohurive në terren, ku konceptet themelore, procesi ekologjik ose ngjarjet e trajtuara në klasë bëhen më të qarta për nxënësit me kuptim të madh, që nxënësit e gjeografisë të arrijnë më të mirën.

Vizitat (aktivitetet jashtëshkollore) në zona të veçanta natyrore dhe kulturore janë mësimi i nevojshëm praktik, që është i përfshirë si pjesë e kurrikulës së gjeografisë, në mënyrë që të sigurojnë që nxënësit të zhvillojnë një kuptim solid të njohurive dhe koncepteve që planifikohet brenda njësive të lëndës së gjeografisë, strategjia e mësimdhënies ka në qendër nxënësin dhe drejtohet nga nxënsi. Aktivitetet jashtëshkollore gjithashtu inkurajojnë fëmijët që të mësojnë këtë shkencë, si dhe të kontribuojnë në rritjen e personalitetit të tyre, për zhvillimin e të menduarit kritik, si dhe zgjidhjen e problemeve socio-emocionale, të eksploroj dhe të vetëvlerësoj rolin thelbësor që luan përfshirja në aktivitete brenda dhe jashtë shkollës në ecurinë mësimore të nxënësve. Nëpërmjet aktiviteteve nxënësve u krijohet mundësia të aplikojnë bazat teorike didaktike, në mësimdhënien e lëndës së gjeografisë, duke u fokusuar tek ora e mësimi.

Pjesëmarrja në aktivitete jashtëshkollore do të sigurojë që fëmijët të kenë një mundësi për të takuar miq të ngjashëm, të thyejnë barrierat shoqërore dhe të ndajnë një lidhje të shëndetshme me ta. Në të njëjtën kohë, ata mësojnë dhe respektojnë vlerën e punës në grup.

E veçanta e vizitave në zona të veçanta natyrore dhe kulturore, synon aftësimin e tyre për të konceptuar siç duhet një orë mësimi dhe çdo etapë të saj, gjithashtu për të organizuar e trajtuar në mënyrën e duhur përmbajtjen e gjeografisë shkollore në stadi të ndryshme të sistemit arsimor.

Për të ofruar përvoja të udhëtimit në terren, që shërbejnë njëkohësisht për objektiva dhe arsytetime të shumta kontradiktore, njëkohësisht edhe nevojën që nxënësi të zhvillohet, ku përmes vizitave

në terren bëhet më e lehtë nxënia e njohurive gjeografike dhe kanë ndikim pozitiv në shumë aspekte, duke i përmbledhur:

- Nxënia e mësimit praktik të njohurive gjeografike.
- Nxënësit mësojnë të përfitojnë njohje konkrete dhe kanë vlerësim më të lartë.
- Promovimi i imazhit të vendit.
- Mbështetjen e nxënësve në ngritjen e vetëdijes dhe aktivitetit shoqëror etj.

Nxënësit përfshihen si pjesëmarrës aktivë në të nxënit dhe jo si spektatorë pasivë në një udhëtim. Një studim efektiv në terren kërkon planifikim të kujdesshëm, përvojat e të mësuarit para, gjatë dhe pas udhëtimit studimor në terren. Mësimdhënësit dhe stafi menaxhues i shkollës duhet të planifikojnë më përpara, arsyetimin dhe objektivat arsimore si dhe logjistikën e udhëtimit e studimit në terren. Pra studimi në terren duhet të plotësojë mësimin në klasës dhe duhet të ndërmerret për të adresuar rezultate specifike, duhet përgatitja e pyetjeve që duhen përgjigjur ose të zhvillojnë udhëzime specifike se çfarë duhet të vëzhgojnë nxënësit ose çfarë informacioni duhet të mblidhet gjatë studimit në terren.

Kjo është metoda konstruktive, që i mundëson nxënësve të mësojnë përmes pjesëmarrjes dhe vëzhgimit në procesin mësimor. Për të arritur qëllimin e studimit, autori ka zgjedhur si metodë kryesore anketat me nxënës dhe intervistat gjysmëstrukturale me drejtorë dhe arsimtarët e gjeografisë, të shkollave që përfshihen në hulumtim. Respondentët e hulumtimit janë: arsimtarët e lëndës së gjeografisë të ciklit të mesëm të ulët, drejtorët dhe nxënësit e klasave 6-9, në Obiliq dhe në Prishtinë.

Puna e planifikuar mirë në terren në gjeografi i shton vlerë të qartë mësimit në lëndën e gjeografisë, si dhe jep një kontribut pozitiv në kurrikulën më të gjerë. Nxënësit fitojnë përvoja praktike, të cilat mbështesin dhe përforcojnë njohuritë, aftësitë dhe konceptet e eksploruara në klasë.

Pritshmëritë specifike të pjesëmarrjes së nxënësve, do të rezultojë në të mësuarit efektiv gjatë udhëtimit studimor në terren, që përfshin planifikimin, konsultimi dhe leja administrative e prindërve, organizimin e mjeteve të transportit, planifikimi i rrugës, përgatitja e materialeve dhe pajisjeve, zonat kontaktuese, pronarët ose organizimi i udhërrëfyesve nëse është e aplikueshme, planifikimi i procedurave të sigurisë dhe emergjencave dhe adresimin me ç'ështëjet që lidhen me pritjet e nxënësve gjatë udhëtimit studimor në terren.

Rezultatet e studimit dëshmojnë se vizitat në zona të veçanta natyrore dhe kulturore gjatë procesit mësimor ndikojnë në ngritjen e rezultateve të nxënësve në aspekt pozitiv, ku nxënësit e marrin edhe si rekreacion dhe ndikon në zhvillimin psikoemocional

Mbi këtë bazë mbetet shqetësuese përkrahja financiare nga institucionet gjegjëse. Andaj rezultatet e fituara nga ky hulumtim pritet që të shfrytëzohen për sensibilizim, lidhur me ndikimin që kanë aktivitetet jashtëshkollës gjatë mësimin të lëndës së gjeografisë.

Fjalët kyçe: aktivitete jashtëshkollore, nxënës, ngritje e rezultateve, vetëvlerësim, zona të veçanta natyrore dhe kulturore, rekreacion.